



**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

Nr.21/2022

Hagë, 02/06/2022

**Përditësim**

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë, informacion për javën e ardhshme dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Në gjykimin *Salih Mustafa*, të enjten e kaluar, më 26 maj, Mbrojtja e z. Mustafa njoftoi mbylljen zyrtare të paraqitjes së provave të veta.

Më 1 qershor 2022, Trupi Gjykses I miratoi kërkesën e mbrojtëses së viktimave dhe caktoi z. Stefan Lerz nga Nederlands Rekencentrum Letselschade të përllogariste dëmet materiale dhe humbjen ekonomike të personave që pretendojnë të jenë viktima të drejtpërdrejta në çështjen *Mustafa. Z. Lerz* duhet të dorëzojë raportin e tij brenda 23 qershorit 2022.

Të premten e shkuar, Trupi Gjykses I miratoi kërkesën e ZPS-së për të dëgjuar kundërdëshminë e një dëshmitari. Seanca u mbajt ditën e djeshme, më 1 qershor dhe ishte kryesisht private.

Në fund të seancës së djeshme, Trupi Gjykses nxori një urdhër me gojë me anë të së cilit u kërkonte palëve, Zyrës Administrative dhe mbrojtëses së viktimave, të rishikojnë transkriptin e seancës për të përcaktuar nëse ka pjesë në transkript që mund të riklasifikohen si publike, por duke respektuar masat mbrojtëse të dëshmitarëve dhe viktimave, sipas nevojës.

Ky urdhër me gojë është në përputhje me “Urdhrin për parashtrime lidhur me heqjen e redaktimeve të transkripteve të seancave gjyqësore ose riklasifikimin e tyre” të Trupit Gjykses, të datës 18 mars 2022, në të cilin Trupi Gjykses u kërkoi palëve, Zyrës Administrative dhe mbrojtëses së viktimave të kryenin rishikimin e transkripteve të seancave të mëhershme dhe, bashkërisht, të dorëzonin parashtrime nëse mund të hiqen redaktimet ekzistuese dhe/ose nëse mund të riklasifikohen transkriptet si





**Informimi javor për median  
Dhomat dhe Zyra Administrative**

Nr.21/2022

Hagë, 02/06/2022

publike.

Urdhri u lëshua në kuadër të respektimit të parimit të së drejtës për gjykim publik, por duke respektuar në të njëjtën kohë masat mbrojtëse të nevojshme për dëshmitarët dhe viktimat. Afati përfundimtar për dorëzimin e parashtrimeve përkatëse është 22 korriku 2022.

Në mbyllje të seancës së djeshme, Kryegjykatësja gjithashtu bëri me dije se datat dhe oraret e seancave të ardhshme në këtë çështje do të shpallen në kohën e duhur.

Në çështjen z. *Thaçi dhe të bashkakuzuarit*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes për apelimin e vendimit të tij, të datës 22 prill, në të cilin lejoi ZPS-në të ndryshonte listën e vet të provave materiale dhe të shtonte material për dy dëshmitarë.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se ndryshimi i listës së provave materiale nuk ndikonte në mënyrë thelbësore në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit gjyqësor apo rezultatin e gjykimit, ndërsa leja lidhur me dy dëshmitarët nuk ishte rrjedhojë e vendimit të kundërshtuar e për këtë arsye nuk mund të apelohej.

Ndër lajmet për komunikim dhe ndërgjegjësim: Dhomat e Specializuara të Kosovës rifilluan programin e vizitorëve për studentët dhe së fundmi kanë mbajtur prezantime dhe diskutime me grupe nga Universiteti Amerikan në Paris, Universiteti DePaul, Universiteti i Mاستrihtit dhe Universitetit i Leidenit.

**Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

